



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Kuvendi i Komunës

Nr.02/ 290

Datë: 06.06.2023

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d, nenit 40 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen lokale, nenit 19 paragrafi 7 pika c) të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871 të datës: 12.11.2008, nenit 36 të Rregullores nr.02/175 datë:31.05.2017 për punën e kuvendit, komiteteve dhe komisioneve të Komunës së Malishevës,

Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e –V- pestë) të rregullt të mbajtur me datë: 30.05.2023 merr këtë:

VENDIM

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT NR.02/95 DATË:0.04.2018 PËR PAGESËN E ANËTARËVE TË KOMISIONEVE DHE KOMITETËVE JO OBLIGATIVE

1.Miratohet ndryshimi dhe plotësimi i vendimit nr.02/95 datë:10.04.2018, për pagesën e anëtarëve të të gjitha Komisioneve dhe Komiteteve të formuara nga Kuvendi i Komunës së Malishevës.

2.Pagesa për komisionet dhe komitetet jo obligative fillon të zbatohet nga momenti i themelimit të tyre, si dhe pagesa të jetë në shumën 50E (pesëdhjeteuro) për mbledhje.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës përmes drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Buxhet.

4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas dërgimit në auteritetin mbikqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 17 të Rregullores nr.01/2017, për procedurën e hartimit dhe publikimi të akteve të Komunës dhe pas shpalljes në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet :

MAPL-së

Arkivit të Komunës

Kryesuesi i Kuvendit
Argjend Thaçi





REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës

Nr. 02/ 95

Datë: 10.04.2018

Mbështetur në nenin 12 paragrafi 12.2 pika d, nenin 40 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen lokale, nenin 19 paragrafi 7 pika c) të Statutit të Komunës së Malishevës nr. 01/871 të datës, 12.11.2008, nenin 36 të Rregullores nr.02/175 datë: 31.05.2017 për punën e kuvendit, komiteteve dhe komisioneve të Komunës së Malishevës, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e mbajtur me datë: 04.04.2018 merr këtë;

V E N D I M

PËR PAGESËN E ANËTARËVE TË KOMISIONEVE DHE KOMITETËVE JO OBLIGATIVE

1. Miratohet vendimi nga Kuvendi i Komunës për pagesën e anëtarëve të Komisioneve dhe Komiteteve jo obligative të formuara nga Kuvendi i Komunës.

2. Mbështetur në nenin 1 të këtij vendimi Komisionet dhe Komitetet jo obligative të formuara nga kuvendi i Komunës janë;

2.1. Komisionit Vlerësues për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme publike.

2.2. Komisionit për Ankesa për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

2.3. Komisioni Komunal i Aksionarëve.

2.4. Komitetit për Planifikim urban, Kadastër, Mbrojtje të Mjedisit, Turizëm dhe monitorim të projekteve publike.

2.5. Komitetit për Diasporë.

2.6. Komiteti për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.

2.7. Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport.

2.8. Komitetit për shëndetësi, mirëqenie sociale dhe persona me aftësi të kufizuara.

2.9. Komitetit për familje të Dëshmorëve, invalid, veteran të luftës së UÇK-së, si dhe martirë të luftës.

2.10. Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, si dhe komisione tjera të formuara nga Kuvendi i Komunës.

3. Pagesa për komisionet dhe komitetet jo obligative fillon të zbatohet nga momenti i themelimit të tyre, si dhe pagesa caktohet e njëjtë me pagesën e Komitetit për Politikë dhe Financa në shumën 50 € (pesëdhjetëeuro) për mbledhje.

4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës përmes drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Buxhet.

5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 17 të Rregullores nr.01/2017, për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunës, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet;

Arkivit të Komunës

Drejtorisë për Ekonomi, Buxhet dhe Financa

MAPL-së.

